

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburanti diesel per Landfillin Bajkaj”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134100-8,

VLERA E FONDIT LIMIT: 7.000.000 (shtatemilione) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ”Bajkaj Land” Sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të pakten një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit për të cilin konkuron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM ”Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare (2020 ,2021,2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet.

Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar , neni 43, pika 4, kjo kerkesë do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet. (Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, neni 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të lotit për të cilin konkurron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrate shërbimi nga një ent publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të lotit për të cilin konkuron, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme pra të jete i pajisur me leje tregëtimi ose licence për tregëtim karburantesh të llojit III/A (gazoil, diesel) ose operatori ekonomik duhet të jete i pajisur dhe të paraqesë licencat/ lejet perkatese për tregëtim me pakice të karburanteve, gazit të lengshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante, që vërteton të drejtën për ushtrimin e aktivitetit (tregëtim karburantesh) të llojit lëshuar nga autoritetet perkatese mbështetur Ligjin nr.8450 date 24.02.1999 dhe VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “për dhenien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe neprodukteve të saj

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin nr.8450 date 24.02.1999 për tregëtim me pakice të karburanteve, gazit të lengshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “për dhenien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe neprodukteve të saj

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetimin të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial që vërteton që operatori ekonomik nuk ka patur penalitete për shkeljen e cilësisë gjatë vitit 2022-2023. (Në rastin e Bashkimit të operatoreve secili duhet të plotësojë këto kriter.)

Argumentimi: Në lidhje me këto pike operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim që leshohet nga ISHTI, ku të referon kërkesat e mësipërme në funksion dhe zbatim të ligjit Nr. 10433 date 16.06.2011 “Për inspektimin në Rrepublicën e Shqipërisë”, si dhe Ligjit Nr. 8450 date 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar. Ky kriter është i rëndësishëm, pasi garanton që Operatori Ekonomik ofron cilësi duke respektuar standardet Ligjore si dhe respekton normat dhe të gjitha masat mbrojtëse duke ofruar produkt sipas standarteve bashkëkohore. Vërtetimi i lëshuar nga ky institucion na siguron që ofrohet furnizim cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet perkatese për ushtrimin e aktivitetit.

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese raport analizimi per tregun e brendshem per produktin Gazoil S.SH.EN:590-2013/A1:2017, leshuar nga Inspektoriati Qendror Teknik, Drejtoria e Laboratit Qendror te Kontrollit. Raport analiza e tregut te brendshem duhet te jete leshuar brenda muajit te fundit nga data e hapjes se tenderit. Operatori ekonomik duhet detyrimisht te paraqese nje ose me shume raport analize te tregut te brendshem. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 77,82 dhe 83 të LPP, nenit 26, 40 pika 6 germa c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteri i mesiperm u vendos me qellim qe te vertetohet se nafta qe operatori tregeton eshte konform standartit te kerkuar ne specifikimet teknike.”

2.3.5. Ofertuesi duhet te paraqes Çertifikate Personale ISO 9001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevlefshme ose standart ISO me e avancuar (e perkthyer e noterizuar), te cilat do te garantonin cilesine e produktit dhe sherbimeve. Çertifikata duhet te jete e vlefshme, e perdituesuar dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne Çertifikate personale ISO 9001:2015 duhet te jete e perfshire objekti i prokurimit. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.6. Ofertuesi duhet te paraqes Çertifikatë Personale ISO 14001-2015 te standartit nderkombetar te menaxhimit te mjedisit dhe /ose te njevlefshme ose standart ISO me e avancuar (e perkthyer e noterizuar), te cilat do te garantonin cilesine e produktit dhe sherbimeve. Çertifikata duhet te jete e vlefshme, e perdituesuar dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne Çertifikate personale ISO 14001:2015 duhet te jete e perfshire objekti i prokurimit. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik duhet te siguroje furnizimin ne objekt sipas nevojave te shoqerise Bajkaj Land Sha. Per arsyen e vendodhjes, dhe ofrimin e furnizimit me karburant duhet te disponojë ne pronesi te vet ose me qera 1 (nje) mjet autobot me kapacitet kapacitet deri ne 2000 litra, per te cilet duhet te paraqese:

- Çertifikaten e pronësisë së mjetit rrugor te regjistruar ne ekstraktin e QKB.
- Lejen e qarkullimit

- Çertifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore. Ne mbështetje të ligjit 8378 datë 22.07.1998 Kodi Rrugor.
- Police për sigurimin e detyrueshëm të mbajtjes së mjeteve për përgjegjësi ndaj paleve të treta. Ne mbështetje të dekretit nr 6077 datë 22.02.2009 dhe ligjit nr 10076 datë 12.02.2009.
- Çertifikate e miratimit për mjete (vetëm për brenda vendit) që transportojnë mallra të rrezikshme. Ne mbështetje të nenit 37 të ligjit Nr.118/2012 datë, 13.12.2012 për transportin e mallrave të rrezikshme.
- Çertifikate e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi. Ne mbështetje të nenit 41/4, të Ligjit nr.152/2015 për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi.
- Çertifikate konformiteti të cisternës rrugore.
- Dokumentacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Ne mbështetje të Ligjit nr.9875 datë 14.02.2008 për metrologjinë.

Ne rastin e marrjes me qera përveç dokumentacionit të mesipër do të paraqesë kontratë noteriale të marrjes me qira të mjeteve. Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar më sipër, për vërtetimin e disponimit të mjeteve në fjalë, ky dokumentacion do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjeteve dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, mbasi mjeteve që operojnë për trajtimin e mbetjeve në venddepozitim janë mjete të renda që nuk dalin në rrugë.

Sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, *si dhe përcaktimet të pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:* “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të garantojë me shkrim se merr përsipër furnizimin në Landfillin Bajkaj sipas nevojave të shoqërisë “Bajkaj Land” Sha, mbasi mjeteve të renda që disponon Autoriteti Kontraktor janë stacionare dhe nuk mund të dalin jashtë objektit, për shkak të specifikës së veprimtarisë që kryhet në landfillin Bajkaj (referuar planit të menaxhimit dhe operimit si dhe efekteve negative në mjedis). (Në rastin e bashkimit të operatoreve secili operator ekonomik duhet të garantojë furnizimin me karburant).

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën 1 (një) pike karburanti në distancë deri në 20 km nga vendndodhja e Landfillit Bajkaj, objekt i Autoritetit Kontraktor “Bajkaj Land” Sh.a, e cila do të shërbejë për furnizimin me karburant. Për këtë operatori ekonomik duhet të dorëzojë një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronarie ose të jenë të pasqyruara në Ekstraktin

e Rregjistrit Tregëtar të Lëshuar nga QKL ose kontrate qeraje) të shoqeruara me dokumentacionin si me poshtë:

- a) Dokumentacionin e pronësive të stacionit të karburantit
- b) Certifikatën për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin për stacionin e karburantit, Ligji nr.152/2015 për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.
- c) Vertetim teknik, lëshuar nga ISHTI, për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet e depozitimit dhe tregimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Ne rast se është me qira ose marrëveshje, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikat a,b,c,d, e duhet paraqitur edhe kontrate noteriale qeraje ose akt pronësie sipas Kodit Civil .

2.3.10. Malli do të ofrohet me autobot, tollona naftë elektronike, karta elektronike dhe të mundësojë faqen e menaxhimit sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme duke e realizuar këtë kërkesë me shkrim në mënyrë zyrtare. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim. Me paraqitjen e kërkesës nga autoriteti kontraktor kontraktuesi është i detyruar të furnizojë autoritetin kontraktor në kohë dhe sasinë e kërkuar duke përfshirë në çmimin e tyre gjithë detyrimet fiskale që ka shteti shqiptar.

Ligji i zbatueshëm për procedurën e prokurimit është Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 pika 3/b, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Ky standart është i njëjtë me S SH EN 590:2018 dhe ka statusin e Standartit Shqipëtar.

Nr	Karakteristikat	Njesia	Kufijte e lejuar		Metoda e testimit
			Min	Mak	
1	Numri cetanit		51		S SH EN ISO 5165:2020 ASTM D 613
2	Indeks i cetanit		46.0		S SH EN ISO 4264:2018 ASTM D 976
3	Densiteti ne 15 C	kg/m ³	820	845	S SH EN ISO 12185:2001 ASTM D 7777 ASTM D 4052
4	Hidrokarbure aromatic policiklik*	%(m/m)	-	8	S SH EN 12916:2006
5	Permbajtja e squfurit	mg/kg	-	10	S SH EN ISO 20848:2019
6	Pika e flakerimit	°C	55	-	S SH EN ISO 2719:2016 ASTM D 93
7	Mbetje karbon(ne 10% mbetje distilimi)*	%(m/m)	-	0.30	S SH EN ISO 10370
8	Permbajtja e hirit	%(m/m)	-	0.01	S SH EN ISO 6245:2002
9	Pika e bllokimit te filtrit ne te ftohte CFFP	°C	-	-	S SH EN ISO 116:2015
10	Korrozioni ne shufer bakri (3 ore ne 50 °C)	Vleresuar	Clas 1		S SH EN ISO 2160:1999
11	Permbajtja e esterit metilik te acidit yndyror (FAME)	% v/v		7	S SH EN 14078 :2014 D 7806
12	Viskoziteti ne 40 °C*	mm ² /s	2.00	4.50	S SH EN ISO 3104:2020 astm d 445-15
13	Permbajtja e ujit*	%(m/m)		0.02	S SH EN ISO 12937:2003
14	Lubriciteti, diametric I korrektuar i gervishtjes (wsd 1.4) ne 60 °C	µm		460	S SH EN ISO 12156-1:2018
15	Pika e turbullimit	°C			S SH ISO 23015:1994
16	Ndotja e pergjithshme	mg/kg		24	S SH EN 12662
17	Stabiliteti i oksidimit (djegjes)*	g/m ³	-	25	S SH EN ISO 12205
18	Destilimi Distivlati qe vlon ne 250 °C Distivlati qe vlon ne 350 °C 95% (v/v) Distivlon ne	%(V/V) %(V/V) °C	85	0<65 360	S SH EN ISO 3405:2019 ASTM D 86
19	Dukshmeria		E qarte e bardhe		ASTM D 4176/2-02

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Karburant Gazoil (10 ppm ULSD)	47,442	Bajkaj Land sha	Çdo muaj (sipas nevojave te shoqerise)

Nese brenda afatit 365 dite sasia e karburantit nuk konsumohet kontrata do vazhdoje deri ne perfundim te sasise se kerkuar.

Shënim:

1. Sasitë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, janë sasi të pritshme. Kjo sasi mund të jetë e ndryshueshme në varësi të çmimit të publikuar nga APP në buletinin javor.
2. Autoriteti Kontraktor do të përcaktojë sasitë përkatëse gjatë zbatimit të kontratës. **Operatorët do të ofertojnë me normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute. Norma e fitimit të shprehur në vlerë absolute do të jetë e pandryshuar gjatë gjithë realizimit të kontratave.**
3. Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.
4. Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shtijes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të cilën është shpallur fitues kontraktor.